



Agron Statovci është një ekspert i kualifikuar dhe i certifikuar në fushën e komunikacionit dhe transportit hekurudhor, me përvojë profesionale prej gati dy dekadash. Gjatë karrierës së tij, ai ka shërbyer në Hekurudhat e Kosovës SH.A si Udhëheqës Treni dhe më pas ka vazhduar në NP HK-Trainkos Sh.A, ku ka mbajtur disa pozita kyçe si: udhëheqës treni, Teknolog në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, U.D. Kryeshef Ekzekutiv dhe Kryeshef Ekzekutiv.

Ai ka përfunduar studimet master në Komunikacion dhe Telekomunikacion në Kolegjin e Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" në Prishtinë, me tezë të fokusuar në të dhënat statistikore dhe bazat inxhinierike për vlerësimin dhe përmirësimin e sigurisë. Gjithashtu, mban një diplomë Bachelor në Komunikacion Hekurudhor dhe Transport nga e njëjta shkollë, me fokus në Ekonominë e Ekspluatimit të Tërheqjes së Trenave në Hekurudhë.

Studimet e mesme i ka përfunduar në QMSHAMEO "Hivzi Sulejmani" në Fushë Kosovë, duke u diplomuar si Teknik i Transportit Hekurudhor.

Statovci është i pajisur me një sërë certifikatash profesionale në fushën e komunikacionit dhe transportit hekurudhor, menaxhimit financiar dhe kontrollit të financave publike.

Kontakti:

☎ 038 534 837

Email:

✉ agron_statovci@trainkos.com